



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI I LËNDËS
DIDAKTIKE E GJUHES 1

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare

Viti / Semestri : Viti III ,semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Hispanik

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:

Edlira Gabili edlira.gabilli@unitir.edu.al

Kamela Marku kamela.marku@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë ka si objektiv kryesor t'i ofrojë studentëve bazat teorike dhe mjetet/instrumentët praktikë të nevojshëm për organizimin e mësimdhënies së gjuhës spanjolle, si një gjuhë e huaj. Gjithashtu, jepet një vështrim i teorive të ndryshme gjuhësore dhe psikologjike që janë në themel të metodologjive të ndryshme. Nga ana tjetër, do të studiohen proceset e ndryshme dhe faktorët që marrin pjesë në mësimin e një gjuhe të dytë, vecanërisht në kontekstin e gjuhëve te huaja dhe situatës në klasë. Përveç kësaj, do të ngrihen çështje praktike me të cilat do të përballet nje pedagog i gjuhëve te dyta.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Të njohë supozimet themelore mbi mësimdhënien e gjuhëve të huaja, (në perspektivën teorike, kritike, historike dhe të krahasuar), dhe në të tjera aspekte teorike.
- 2.Të njohë terminologjinë specifike në fushën e përvetësimit të gjuhëve te dyta.
3. Të njohë zhvillimin historik të metodave të ndryshme për mësimdhënien e gjuhëve të huaja.
4. Të zhvilloje kapacitetin e tij në punë vetjake dhe punë në grup.
- 5.Të fitojë njohuri teorike bazë të cilat do i shërbejnë për ti vënë në praktikë në të ardhmen e tij profesionale.